



Misioni i OSBE-së në Shkup
Bulevardi "8 Septemvri" nr. 16
1000 Shkup

Çfarë mund të bëni ju dhe komuniteti juaj?

Ngritni zërin kundër urrejtjes dhe jotolerancës. Tregojuni viktimave se kujdeseni për ata nëpërmjet angazhimit tuaj shoqëror dhe duke iu ofruar atyre mbështetje dhe ndihmë.

Inkurajoni nëpunësit publikë që t'i kundërvihen krimit nga urrejtja.

Themeloni një koalicion të shumëllojtë, të përbërë nga organet për zbatimin e ligjit, komunat, shkollat, grupet fetare dhe organizatat e shoqërisë civile, i cili urgjentisht do t'i përgjigjet krimit të kryer nga urrejtja, do të promovojë parandalimin e tij, si dhe do të bëjë ndërgjegjësimin e publikut.



Informacion për viktimat e krimeve të urrejtjes

Denoncimi dhe ndihma juridike

Ç'është krimi i urrejtjes?

Çdo vepër penale ndaj një personi fizik ose juridik, i cili është kryer në tërësi ose pjesërisht për shkak të tiparit real ose të perceptuar të një personi që lidhet me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose bindjen, aftësinë e kufizuar mendore ose trupore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politike.

Si të identifikojmë krimin e urrejtjes?

- Perceptimi i viktimës ose dëshmitarit se janë të përzgjedhur nga sulmuesi për shkak të përkatësisë së tyre në një grup të mbrojtur.
- Komentet me shkrim ose me gojë të sulmuesit, që mund të sugjerojnë një paragjykim.
- Data e incidentit përputhet me një ditë që ka rëndësi për grupin e mbrojtur të cilit i takon viktimë.
- Përkatësia e ndryshme etnike, politike ose fetare e viktimës dhe sulmuesit.
- Aktiviteti i një grupi të urrejtjes, i organizuar në lagjen ose në rrethin.
- Incidente të mëparshme të ngjashme dhe kërcënime ose abuzime verbale.



Çfarë duhet bërë nëse jeni viktimë e krimit të urrejtjes?

- Denonconi rastin në polici, duke u paraqitur menjëherë në numrin 192.
- Merrni ndihmë mjekësorë (nëse është e nevojshme).
- Shënoni saktë fjalët e shqiptuara dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i dobishëm.
- Kërkoni dëshmi (grafite, gurë, armë). Mos largoni asnjë provë. Bëni foto. Pritni reagimin e policisë.
- Merrni emrat, adresat dhe numrat e telefonit të dëshmitarëve.
- Nëse është e mundur, përshkruani sulmuesin dhe automjetin e tij.

Ku ta bëni denoncimin?

Krimi i urrejtjes gjithmonë duhet të denoncohet në polici. Megjithatë, nëse hezitoni që menjëherë të flisni me policinë, ekzistojnë mënyra tjera për të denoncuar një incident përmes:

- redbutton.mvr.gov.mk
- zlostorstvaodomraza.mk

Në qoftë se jeni kërcënuar 'online' nga një sulmues i njohur ose i panjohur për shkak të përkatësisë tuaj në një grup të mbrojtur, denoncojeni atë në:

- cybercrime@moi.gov.mk

Ndihmë juridike

Komiteti i Helsinkit është një organizatë e shoqërisë civile që mund t'ju ndihmojë në aspektet ligjore të rastit tuaj. Ata mund të vendosin t'ju shoqërojnë në një stacion policor, të shkruajnë padinë tuaj penale dhe të vëzhgojnë rastin tuaj gjatë hetimeve dhe procedurës gjyqësore.



Rr. "Naum Naumovski Borçe" 83, 1000, Shkup
Tel. 02 3119 073, helkom@mhc.org.mk